

POP 5

1

EKSKLUZIVË: 'Deka' paska qenë e shtunë komplet, vetat i autorit që Report Tv ka shantazhuar me foto për ruse, na tha se 'është lidhur dhe me jetën'

2

Amasat famëliqë! Fiqiri Mjeshtri mori në telefon vëllezërit dhe ia shkroi me armë vetes

3

FOTO/ Kuat është 39-vjeçari që vrau babë e bir në Klos e më pas vetes? Dytshet se dashurohet me vajzën e tij

4

FOTO/ Kuat është 39-vjeçari që vrau babë e bir në Klos e më pas vetes? Dytshet se dashurohet me vajzën e tij

5

Vajza në Klos, dashurë dashura e vajzës së autorit! Më ndalojnë në Instagram, koha 5 ditë pa shkruar në shërbim

6

Samiti regional në Kosovë, Rilindja bashkë me Putnik dhe Erdogan! Porse kamkaxë iranjan mbi Kler, sulmohen meçinat e kryeqytetit

Kronikë

Tragjedia me 3 viktimë, Report Tv në Klos! Në vendin e masakrës vendosen lule! Familja Shira hap dyert e mortit! Banorët: Me fisin Mjeshtri kishin lidhje gjaku

Heshija dhe zia ka përfshirë qytetëzën e Klosit, një ditë pas ekzekutimit të babë e bir Kenado e Liri Shira. Një ekip i Report Tv ndodhet në Klos, aty ku banorët shprehen të tronditur dhe rrefejnë se dy familjet tashmë në hasmëri, kanë lidhje gjaku.



Familja nga vendi ku ndodhi masakra dhe nga atëzipsa e familjes Shira

Redakcia

13 Tetor, 10:37 | Përditësimi: 13 Tetor, 11:15



KLOS- Heshija dhe zia ka përfshirë qytetëzën e Klosit, një ditë pas ekzekutimit të babë e bir Kenado e Liri Shira. Një ekip i Report Tv ndodhet në Klos, aty ku banorët shprehen të tronditur dhe rrefejnë se dy familjet tashmë në hasmëri, kanë lidhje gjaku.

Në fshatin Fullçet, në banesën e familjes Shira, e cila ka hapur dyert e mortit pas vrasjes së djallit të vetëm 17-vjeçarit, Kenado Shira dhe babait të tij Liri Shira, një ditë më parë në qendër të Klosit nga Fiqiri Mjeshtri, ka pllakosur zia. E njëjta panoramë e trishtë paraqitet edhe në fshatin Dars, në banesën e Fiqiri Mjeshtrit, vend ku 39-vjeçari i dha fund jetës pak pas vrasjes së dyfishtë dhe plagosjes së Eglantinit dhe Renado Hasulës.

LEXO EDHE:

Rrihte vazhdimisht gruan, ndërsa vajza e mitur konsumoi mbidozë ilaçesh nga dhuna psikologjike e të atit! Në pranga 42-vjeçari në Maqellarë!

Babai i adoleshentit, Liri Shira, kishte vetëm dy javë që ishte kthyer nga Norvegjia në fshat, që të sqaronte problemin mes të rinjve, kjo pasi i ishte kërkuar nga babai i të miturës Fiqiri Mjeshtri që të vinte. 3 ditë para datës 12, familja Mjeshtri dhe Shira janë takuar dhe e kanë mbyllur bisedën mes tyre. Por Renato Hasula, kushëri i 17-vjeçarit Kenado Shirës, ka ngacmuar sërish vajzën e mitur, që është bërë shkas më pas për tragjedinë me 3 të vdekur një ditë më parë.

Djali i mitur studentin në shkollë profesionale në Durrës, ndërsa banorët tregojnë për Report Tv se fiset Mjeshtri e Shira kishin lidhje gjaku ndërmjet tyre.


Ndërkohë në **vendin e masakrës**, ku mbetën të vrarë babë e bir në qendër të Klosit, nuk ka mbetur asgjë përveçse një trëndafil, në kujtim të 17-vjeçarit të ndjerë.

Mësohet se dy të miturit, Kenado Shira dhe Renado Hasula, njiheshin me vajzën e Fiqirit, 17 vjeçe. E mitura pretendon se përndiqej nga dy bashkëmoshatarët, kryesisht përmes rrejtëve sociale. Në korrik të këtij viti vajzës iu vodhën dy adresa në rrjetin social Instagram, fillimisht nga Kenado, i cili e shantazhonte dhe kërcëonte se do t'ia bënte publike të gjitha pamjet dhe fotot që kishte në bisedat e rrjetit social. Tre javë më parë është diskutuar dhe sqaruar mes familjeve kjo histori dhe konsiderohej e mbyllur. Pesë ditë para masakrës me tre viktimë dhe dy të plagosur, Renato Hasula ka rinisur ta kërcënojë të miturën.

Si ndodhi tragjedia në Klos (12 tetor)
Ngacimet dhe shantazhet e vazhdueshme, në Instagram që dy të rinjtë Kenado Shira, 17 vjeç, dhe Renado Hasula, po 17 vjeç, (djem tezezh) kanë bërë kundrejt vajzës së Fiqiri Mjeshtrit, shkaktuar një tragjedi në Klos, me tre viktimë dhe dy të plagosur. 39-vjeçari Fiqiri Mjeshtri, qëllori disa herë me pistoletë në rrugën kryesore të qytetit, duke lënë të vdekur në vend 17-vjeçarin Kenado Shira, ndërsa babai i tij Liri Shira ndërroi jetë rrugës për në spital. Autori, Fiqiri Mjeshtri u gjet i vetëvrarë në shërbimin e tij në fshatin Dars. Në këtë masakër mbetën të plagosur dhe babë e bir, Eglantini dhe Renado Hasula.

Në deshminë e saj para hetuesve, vajza e autorit është shprehur se ajo shantazhohej nga dy kushërinjtë në Instagram dhe se kishte disa ditë që nuk shkonte në shkollë. Kjo gjendje e së bijës është vënë re nga autori, Fiqiri Mjeshtri, i cili e ka pyetur dhe ajo i ka treguar arsyen. Pas kësaj, 39-vjeçari bashkë me dy vëllezërit e tij, ka kërkuar që të sqarohet me dy të miturit. Rreth orës 14:00, të ditës së sotme (12 tetor), tre vëllezërit Mjeshtri, dy anëtarët e familjes Shira dhe dy të familjes Hasula ishin ulur në kafe për tu sqaruar. Duket se biseda ka degraduar në sharje e fyerje. Ata kanë dalë jashtë kafes, ku 39 vjeçari ka nxjerrë pistoletën, duke shkaktuar dy viktimë e dy të plagosur. Dy të plagosurit, Eglantini Hasula dhe i biri 17-vjeçar Renato janë në spitalin e Traumës. 39-vjeçari është në gjendje të rëndë, ndërsa i biri jashtë rrezikut për jetën.

Redakcia po punon për të sjellë më shumë informacione...



Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 13:13

Masakra me tre të vdekur në Klos, Çollaku: Të gjithë jemi fajtor, drejtorit të policisë s'i kishte mbetur gjë tjetër veçse të mblidhte viktimat

Deputeti i Partisë Demokratike, Kreshnik Çollaku ka reaguar në lidhje me masakrën me tre të vrarë një ditë më parë në Dibër. Çollaku u shpreh se të gjithë jemi fajtor dhe se drejtorit të policisë i kishte mbetur që të mblidhte viktimat.


“Çfarë pash unë dje? Pashë drejtorin e policisë së qarkut, ishte i fikur, si drejtor agjencia funerale. I kishte mbetur vetëm një gjë të mblidhte viktimat. Kryepolici gjithsesi duhet të ishte i fundit të ndihje me fat. Të gjithë jemi fajtor, një histori e nisur në bankat e shkollës, që çon dy familje në përplasje. Fajtor është varfëria, degradimi, rinia e shkollave të mësmë kalon ditën nëpër klube me alkoolë e hashash, pasi nuk bëhet më mësim në gjimnaz. Kryeministri trajtoj grevën e pedagogëve me shpërfilje e u thashë se në duart e tyre kemi fëmijët. Ja dhe fëmijët se çfarë bëjnë. Gjithçka ndodhi në një qytet shumë të mirë e të butë...” u shpreh Çollaku.



Ora 12:45

Mbetën të plagosur nga masakra në Klos, ja si është gjendja e babë e bir në spitalin e Traumës

Renato Hasula, 17 vjeç dhe babai i tij Eglant Hasula, 39 vjeç e kanë kaluar rrezikun për jetën. Babë e bir mbetën të plagosur një ditë më parë nga plumbat e Fiqiri Mjeshtrit, në qendër të Klosit.



Ora 10:44

Tragjedia me 3 viktimë në Klos! Banorët: Familja Shira dhe Mjeshtri kishin lidhje gjaku

Për mikrofonin e Report Tv, të afërm të familjes Shira kanë zbuluar një detaj tronditës nga ngjarja e rëndë në Klos. Ata shprehen se familja Shira me familjen Mjeshtri ishin kushërinj, prandaj janë shprehur të habitur se si djali Kenado Shira mund të ngacmonte vajzën e Fiqiri Mjeshtrit.

“Unë di si familja, i ati ka qenë shumë njeri pozitiv, ka pas punuar në Norvegji me letra dhe gjithë pasurinë e kishte investuar këtu, dhe ka pas një djallë të vetëm, Kenado. Ka mbaruar shkollën profesionale. Familja Mjeshtri, madje e di që binin edhe gjak”.

“Ata janë gjak, janë të dytë kushëri”

“Jemi gjak e milet, të atin e çunit, Lirin, e njoh, ndërsa çunin nuk e njoh, jam habitur, se gjak të afërt tjetri, gjak këto, kështu shkuan punët”, thanë të afërmit.



Ora 10:05

Lirohen 2 vëllezërit e Fiqiri Mjeshtrit që vrau babë e bir në Klos! 2 kushërinjtë shantazhonin vajzën e autorit se do t'i publikonin bisedat personale në Instagram

KLOS- Pas marrjes në pyetje, **vëllezërit e autorit të krimit të dyfishtë në Klos**, Fatmir e Besnik Mjeshtri, janë lënë të lirë. Shtatë herë u shkrep arma e zjarrit pasditen e djeshme nga Fiqiri Mjeshtri, një prej plumbave dhe të fundit, vetes. U qëllua me një pistoletë tip TT, të cilën 39-vjeçari e kishte pa leje.


Mësohet se dy të miturit, Kenado Shira dhe Renado Hasula, njiheshin me vajzën e Fiqirit, 17 vjeçe, madje e mitura pretendon se përndiqej nga dy bashkëmoshatarët, kryesisht përmes rrejtëve sociale.

Në korrik të këtij viti vajzës iu vodhën dy adresa në rrjetin social Instagram, fillimisht nga Kenado, i cili e shantazhonte dhe kërcëonte se do t'ia bënte publike të gjitha pamjet dhe fotot që kishte në bisedat e rrjetit social. Tre javë më parë është diskutuar dhe sqaruar mes familjeve kjo histori dhe konsiderohej e mbyllur. Pesë ditë para masakrës me tre viktimë dhe dy të plagosur, Renado Hasula ka rinisur ta kërcënojë të miturën.

Ajo, tre ditë e fundit nuk është paraqitur fare në shkollë, nga shantazhi dhe kërcënimet. Pas këtij momenti, ajo i tregoi të atit çfarë po ndodhte, teksa ky i fundit ka thirrur të atin e Kenados, Liri Shira dhe vëllain e vetë, Fatmirin, për të sqaruar situatën. Në kafenenë ku janë takuar nisi debati, që përfundoi në të shtëna me armë zjarri.

Në vendin e ngjarjes u gjetën 5 gëzhoja, por u qëllua me shtatë plumba, pasi njëra nga predhat u konstatua në vonë në vendngjarje. Vëllezërit e tij komunikuan me policinë pas krimit për të negociuar me Mjeshttrin, por që pas disa minutash u gjet i vetëvrarë 100 m larg banesës së tij.

Renado ka deklaruar para hetuesve, i pyetur në Spitalin e Traumës, ku ndodhet për mjekim, se do të japë shpjegime të të miturës. Babai i tij, Eglantini Hasula ndodhet në reanimacion në gjendje të rëndë dhe në pamundësi për të dëshmuar.



Besnik, Fatmir dhe Fiqiri Mjeshtri



M.Q./Shqiptarja.com

TAGJ

Other

Klos

FIQIRI MJESHTRI

fullçet

kenado shira

liri shira

Komente

Malesori i jugut:

13/10/2022 12:54

Vazhdoni te shantazhoni dhe se publikoni foto minorenesh tani, gangstera.

Përgjigju

Tradita:

13/10/2022 11:48

Absolutisht kane marre çfare kane kerkuar! 25 vjeç e poshte po rritet brez rrumpalle, tufaxhij qe bien era shurre dhe kujtojne se çdo gjë qe shkelqen eshte flori Fiqiri u qofte dheu i lehte por ka bere gabim qe ka vrare veten! Ngushellime familjes Mjeshtri!

Përgjigju

Ngushellime familjes Mjeshtri:

13/10/2022 10:54

Fiqiriut i kumte pushkal Gynah vetem qe vrau veten. Te tjeret kane marre sa kane kerkuar, meritojne vetem perbuze

Përgjigju

Ndalohejt rreptësisht ripublikimi i këtyr shkrimit, sipas nenit 80, ligji 13/01/2016

Sondazhi i ditës:

Fjalimi i Ramës në KiE për të rrëzuar raportin e Dick Marty, a besoni se do bëhet drejtësi për ish- luftëtarët e UÇK?

PO

JO

NUK E DI

Lajme të tjera

Sociale

Sport

Drejt Punës



Bulgjzë, vijon regjistrimi i tokës bujqësore! 1600 pasuri regjistrohën në emër të pronarëve në Gjiroçë

25 Shtator, 12:15



Hakik Çekiçi, nga imami në trajner ambicioz në fushë! Endrra është një stadium në Bulgjzë

23 Shtator, 11:24



'Shqipëria Turistike!' Zerqani, fshati me traditë i Dibres, shtëpia monument kulturore e Mustafë Shehut dhe pylli mistik "Zabeli i Vakëfit"

30 Korrik, 11:00